



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 13 gusht 2019

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 5 të Rregullores Nr.06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës dhe në bazë të Vendimit KPK/Nr.461/2019 shpall:

KONKURS

Për emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

- I. Kandidatët e interesuar për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - 1.1 Të jenë prokurorë me mandat të përhershëm;
 - 1.2 Të mos kenë të ngritur aktakuzë;
 - 1.3 Të mos jenë të dënuar për vepër penale;
 - 1.4 Të kenë vlerësim pozitiv të performancës në tri vitet e fundit;
 - 1.5 Të mos kenë të shqiptuar sanksion disiplinor në pesë vitet e fundit, duke përjashtuar qortimin dhe vërejtjen jo publike;
 - 1.6 Të kenë reputacion të lartë profesional dhe integritet moral.
- II. Kandidatët e interesuar për Kryeprokuror të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës duhet të plotësojnë aplikacionin, Koncept dokumentin për menaxhimin e prokurorisë dhe Vetë vlerësimin, të gjitha këto të publikuara në faqet zyrtare të KPK-së dhe PSH-së, si dhe autobiografinë (CV) dhe çfarëdo dokumenti tjetër relevant për të dokumentuar përvojën e tyre, përfshirë rekomandimet.
- III. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon kandidatët e gjinisë femërore dhe kandidatët nga komunitetet jo shumicë që i plotësojnë kriteret e lartë cekura, që të aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.
- IV. Konkursi do të jetë i hapur nga data 14 gusht 2019 deri me 28 gusht 2019.
- V. Aplikacionet duhet të dorëzohen te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e katërt (4) të ish ndërtesës së EULEX-it, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 413, të mbyllura në zarf, ose me postë.